



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË REGJIONALE TË MBETURINAVE "UNITETI" SH.A. PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. (KRM "Uniteti" sh.a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. deri me 31 dhjetor 2023, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- B1 Mos përputhje e obligimeve tatimore në vlerë prej 1,729,701€ në mes shënimeve kontabël të ndërmarrjes dhe gjendjes në Administratën Tatimore të Kosovës
- B2 Mos përputhje e gjendjes së pasurisë afatgjatë në vlerë prej 1,294,302€ të prezantuar në pasqyrat financiare dhe vlerës së pasurisë në regjistrat kontabël.
- B3 Llogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për 49,225€ për shkak se 11 debitorë (klientë) janë pasiv përderisa kompania i mban në regjistra. Kjo rezultoi në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme të cilat entiteti nuk pret t'i arkëtojë gjatë rrjedhave normale të biznesit.
- B4 Kompania në pasqyrat vjetore financiare kishte prezentuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 3,879,353€. Prej tyre 85% apo 3,302,112€ janë më të vjetra se një vit. Kompania nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizionime vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Kompanisë Regjionale të Mbeturave "Uniteti" sh.a. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- C1 Ndërmarrja nuk ka vendos në mënyrë të duhur sistemin e kontrollit të brendshëm në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregullorja MF -01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Pasiqë kompania funksionon pa zyrtar për auditim të brendshëm, nuk ka rregullore për menaxhimin e pasurisë, politika dhe procedura kontabël dhe rregullore të pa azhurnuara dhe të paplota, nuk ka listë të proceseve dhe regjistër të rreziqeve.
- B5 Kompania nuk ka përgatitur një regjistër të detajuar të pasurive, i cili duhet të përfshijë të gjitha kërkesat e rregullores së brendshme për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste. Për me tepër pasuritë nuk mbahen në softuer të kontabilitetit por në Excel, nuk kanë numër inventarizues dhe një pjesë e pasurisë janë të regjistruar në grup.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetjet që kanë ndikuar në opinionin e auditimit janë: Mos përputhje e obligimeve tatimore, mos përputhje e gjendjes së pasurisë, mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve/pasurive të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, nëntë (9) rekomandime janë të përsërituara, një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur. Përderisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos përputhje e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël të Kompanisë me gjendjen e obligimeve në ATK

Gjetja

Sipas Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Kompania në kuadër të detyrimeve afatshkurta në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar obligime tatimore në vlerën prej 2,049,460€, ndërsa bazuar në gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit si dhe pas konfirmimit të pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), obligimet totale tatimore të kompanisë ndaj ATK-së janë në vlerë prej 3,779,161€. Prandaj, kompania nuk kishte prezantuar drejtë obligimet tatimore në pasqyrat financiare në fund të vitit 2023 për vlerën prej 1,729,701€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit ndër vite të obligimeve tatimore të kompanisë me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK

Ndikimi Mos barazimet periodike te detyrimeve ka ndikuar që prezantimi i obligimeve tatimore të mos është i saktë në pasqyrat financiare vjetore duke i nënvlerësuar obligimet afatshkurtra të kompanisë dhe kjo reflekton me pasqyrim të gjendjes jo reale (çorientuese) të pozicionit financiar të kompanisë.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që obligimet tatimore të kompanisë të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK dhe të prezantohen saktë në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos përputhje e vlerës se pasurisë në regjistrat kontabël me vlerën e prezantuar në pasqyrat financiare

Gjetja Sipas Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Kompania, në pasqyrat financiare kishte prezantuar pasuri afatgjatë në vlerë prej 2,966,248€ përderisa vlera neto e pasurisë afatgjatë në regjistrin e pasurisë me datë 31.12.2023 ishte 1,671,946€. Kjo mos përputhje ka shkaktuar mbivlerësim të pasurisë në pasqyrën e pozicionit financiar për 1,294,302€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Kompania nuk kishte harmonizuar vlerën e pasurisë sipas regjistrave kontabël, me vlerën e pasurisë afatgjatë të prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shënimet shpjeguese përkatëse.

Ndikimi Mos prezantimi i saktë i vlerës së pasurisë afatgjatë në pasqyrat financiare vjetore ka ndikuar në mbivlerësim e pasurisë afatgjatë si dhe reflekton me pasqyrim të gjendjes jo reale (çorientuese) të pozicionit financiar të kompanisë.

Rekomandimi B2 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se para çertifikimit të pasqyrave financiare, ato i nënshtrohen një procesi të rishikimit të hollësishëm në mënyrë që prezantimi i pasurisë afatgjatë, të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme**Gjetja**

Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, pasqyra e pozicionit financiar duhet të prezantoj pozicionin financiar në datën e raportimit, duke prezantuar gjendjen e pasurive, detyrimit si dhe kapitalin, mbi bazën e të dhënave kontabël në po të njëjtën datë. Po ashtu, Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12 Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve përcakton se, Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit në përmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Ndërsa, neni 2 përcakton se inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Për të testuar ekzistencën e llogarive të arkëtueshme tregtare, ne kemi dërguar nëntëmbëdhjetë (19) letër konfirmime te klientët në vlerë të përbashkët prej 241,436€. Prej tyre kemi pranuar vetëm një letër konfirmim në vlerë prej 135,479€. Për rastet që nuk janë kthyer letër konfirmimet kemi zhvilluar procedura tjera të auditimit dhe kemi identifikuar se njëmbëdhjetë (11) klientë në vlerë 49,225€ që kompania i mban në regjistra janë biznese pasive. Fakti që klientët e tillë nuk ekzistojnë apo janë mbyllur, rezulton në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme të cilat entiteti nuk pret të i arkëtojë gjatë rrjedhave normale të biznesit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte bërë procesin e inventarizimit/harmonizimit të gjendjeve me klientë në baza periodike.

Ndikimi

Mungesa e kontroleve adekuate në sistemin e kontabilitetit si dhe mos harmonizimi periodik i të dhënave të ndërmarrjes dhe klientëve të saj, ndikon në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi B3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizime periodike të gjendjes së llogarive mes kompanisë dhe klientëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e kompanisë dhe vizitat të debitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të kërkesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Mosprovizionim i llogarive të arkëtueshme tregtare****Gjetja**

Sipas SNRF 9 Instrumentet financiarë, entiteti mund të llogaris humbje të pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Entiteti do të përdorë përvojën e saj historike për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën e aktivitetit financiar. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, entiteti do të përdor grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.

Kompania kishte prezantuar në pasqyrat vjetore financiare me 31 dhjetor 2023, llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 3,879,353€. Prej tyre 85% apo 3,302,112€ janë më të vjetra se një vit. Kompania nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizionime vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018. Edhe përkundër zotimit në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Prandaj, mungesa e aplikimit të lejimeve/provizionimeve ndër vite ndikon që vlera bartëse neto e llogarive të arkëtueshme tregtare prej 3,879,353€ në PVF të mos jetë e saktë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti në pesë vitet e fundit nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të provizionimit të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme tregtare në pesë vitet e fundit është në kundërshtim me kërkesat e standardeve të kontabilitetit për matjen e aktivitetit financiar dhe ka ndikim material në vlerën neto të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare

Rekomandimi B4

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët, kurse shuma e provizionit të përcaktohet sipas rregullores për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja C1 - Mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm

Gjetja

Sipas Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 4, pikat 1.1 deri 1.9 theksojnë se Udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik, në këtë rast Bordi, ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit të subjektit dhe për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe proceseve që ndërlidhen me zbatimin e tyre.

Ndërmarrja nuk ka vendos në mënyrë të duhur sistemin e kontrollit të brendshëm. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Kompania kishte themeluar Komitetin e Auditimit mirëpo ende nuk ka rekrutuar auditorin e brendshëm. Kompania nuk kishte pasur sukses në rekrutimin e auditorit të brendshëm në dy konkurset e shpallura gjatë vitit 2022 dhe 2023;
- Nuk ka rregullore për menaxhimin e pasurisë, rregullore për përshkrimin e vendeve të punës dhe përcaktimin e gradës për secilën pozitë, rregullore për menaxhimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme, listë me përshkrim të proceseve si dhe kodin e etikës të pa azhurnuar nga viti 2009;
- Nuk ka një regjistër të rreziqeve dhe politikë për menaxhimin e rrezikut;
- Menaxhmenti gjatë vitit 2023 kishte bërë vetëm një raportim për periudhën Janar-Qershor për Bordin Drejtues.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve konkrete nga Bordi Drejtues për vendosjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm të adekuat për kompaninë.

Ndikimi

Mos vendosja e një sistemi të kontrollit të brendshëm të plotë ndikon në performancën e kompanisë përball përcaktimit të objektivave të saj. Po ashtu mangësitë e tjera të përshkuara më lart mund të ndikojnë që kompania të mos arrij të përmbush obligimet operative dhe financiare të saj.

Rekomandimi C1

Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të funksionalizohet Njësia e Auditimit të Brendshëm, të azhurnohen dhe plotësohen politikat, procedurat dhe rregulloret për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes, të përgatitet lista e proceseve dhe regjistri i rreziqeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Regjistri i pasurisë jo në përputhje me rregulloren e kompanisë

Gjetja

Sipas nenit 14, të Rregullores për Zbatimin e Procedurave dhe Politikave Afariste, kompania është e obliguar që të ketë regjistrin e detajuar të pasurive fikse, cili mbahet në softuerin e kontabilitetit dhe duhet të përmbajë këto elemente: numrin rendor të pasurive, emri i pasurisë, emrin e kompanisë nga e cila është blerë, numrin inventarizues, njësinë e kompanisë ku është vendosur, datën e blerjes, kostoja historike, grupi zhvlerësues në përqindje, zhvlerësimi i vitit të tanishëm dhe zhvlerësimi i akumuluar, vlera neto kumulative sipas grupeve të pasurive.

Kompania nuk ka përgatitur regjistrin e pasurive afatgjata, sipas kërkesave të rregullores për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste si: datën e blerjes, grupin zhvlerësues në përqindje, numrin inventarizues (numrin e barkodit). Për më tepër pasuritë nuk mbahen në softuer të kontabilitetit por në Excel dhe një pjesë e pasurisë janë të regjistruar në grup dhe jo artikull për artikull si: kompjuter 20 copë, Laptop 5 copë, Printer 4 copë, Karrika levizëse 29 copë etj.

Kjo ka ndodhur për shkak se kompania ishte e pakujdeshme në zbatimin e rregullores së brendshme.

Ndikimi

Mungesa e regjistrit të plotë për menaxhimin e pasurisë ndikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B5

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që është hartuar një regjistrin i brendshëm për menaxhimin e pasurive i cili i përmban të gjitha elementet të cilat kërkohen me rregulloren e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Detyrimet afatshkurta

Vlera neto e zërit financiar të detyrimeve afatshkurtra e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 2,247,636€.

Çështja B6 - Mos prezantimi i saktë i obligimeve në regjistrin e kompanisë

Gjetja	<p>Bazuar në Kuadrin konceptual për raportim financiar, paragrafi 4.46, një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri.</p> <p>Kompania nuk kishte prezantuar drejtë llogaritë e pagueshme në pasqyra financiare, ngase në regjistrat e saj nga viti 2019 mban si llogari të pagueshme shumën prej 97,703€ ndërsa sipas një vendim të gjykatës, borxhi për atë klient ishte 86,941€. Gjatë vitit 2020 kompania kishte paguar shumën prej 20,914€ duke e zbritur borxhin në 76,789€ ndërsa jo duke e zbritur nga vlera 86,941€ sipas vendimit të gjykatës. Si rezultat llogaritë e pagueshme ishin mbivlerësuar për 10,762€.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm si dhe për shkak të mos harmonizimeve të brendshme mes zyrës ligjore dhe departamentit të financave.</p>
Ndikimi	Kjo ka ndikuar në mbivlerësimin të llogarive të pagueshme në Pasqyrat Financiare.
Rekomandimi B6	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se regjistrat e kontabilitet janë të saktë dhe të plotë dhe komunikimi dhe shkëmbimi i informatave mes sektorëve në ndërmarrje të jetë në nivelin e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në shumën 678,256€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime mirëmbajtjes, shpenzimet e derivateve, shpenzimet e trajnimit dhe udhëtimit, shpenzimet e zyrës dhe ato administrative, shpenzimet e mjeteve motorike, shpenzimet e qirasë dhe të tjera.

Çështja B7 - Prokurimi i mallrave të përdorura

Gjetja Ligjin i Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe legjislacioni dytësor nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që e rregullon prokurimin e mallrave të përdorura.

Mirëpo opinioni i KRPP (Opinion i KRPPM 4. 22.11.2022) lidhur me prokurimin e mallrave të përdorura ndër tjera thekson se prokurimi i mallrave të përdorura nuk rekomandohet, ngase specifikimet teknike siç përcaktohen nga autoriteti kontraktues nuk garantojnë domosdoshmërisht se dy apo më shumë mallra që kanë të njëjtat specifikime teknike kanë edhe kapacitetet e njëjta në kushtet përformancës dhe funksionalitetit. Poashtu pamundësia për të krahasuar dy tenderë identik do të përbëjë një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të konkurrentëve.

Në procedurën e prokurimit "Furnizim me 2 (dy) kamionë kompaktor" në vlerë prej 71,800€ kemi vërejtur se në dosjen e tenderit tek specifikimet teknike, kompania kishte vendosur njërin nga kriteret që viti i prodhimit të kamionëve të jetë 2008 ose më i ri. Rrjedhimisht kompania ishte furnizuar më dy kamion të vitit të prodhimit 2008 përkatësisht 2009.

Kjo praktikë ishte aplikuar edhe vitet e kaluara, edhe pse menaxhmenti në planin e veprimit ishte zotuar që do të bëjë përpjekjet e nevojshme për shnangur prokurimin e mallrave të përdorura, mirëpo gjendja ishte përsëritur edhe vitin 2023.

Shkaku i veprimeve të tilla, sipas zyrtarëve të kompanisë, ishte mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme për furnizim me makineri të reja.

Ndikimi Prokurimi i mallrave të përdorura mund të vështirësoj procesin e vlerësimit të ofertave dhe si rrjedhojë mund të vë në pikëpyetje cilësinë e makinerive që pritet të përdoren në vitet në vijim nga kompania.

Rekomandimi B7 Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që para inicimit të procedurave të prokurimit, të mos ekzekutojë asnjë aktivitet të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B8 - Mos përdorimi i sistemit të E-prokurimit për modulën e kontratave**Gjetja**

Rregulla e prokurimit publik nr. 001/2022 neni 70.1 Menaxhimi i Kontratës - i referohet administrimit të implementimit të kontratave nga ana e autoritetit kontraktues nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistemit të prokurimit elektronik. Të gjithë zyrtarët/ personat e caktuar/emëruar si menaxherë të kontratës si nga ana e AK dhe OE duhet të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës. 70.2 Vlerësimi i performancës së kontraktuesve - i referohet vlerësimin të performancës së kontraktuesve gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë. Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve.

Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë në vijim lidhur me mospërdorimin e modulit të prokurimit:

Mungesën e vendosjes së raportit të vlerësimin në e-prokurim, mos emërimin e mbikëqyrësit të menaxherit të kontratës, mungesa e zhvillimit të planit për menaxhimin e kontratës përmes modulit në platformën E-prokurimit si dhe mungesa e vlerësimin të performancës së kontratës në E-prokurim.

Këto mangësi janë evidentuar të kontratat në vijim:

- "Furnizim me 2 (dy) Kamiona Kompaktor " në vlerë 71,800€,
- "Furnizim me vajra motorike dhe lubrifikant për makineri të rëndë" në vlerën 117,336€,
- "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" në vlerë 16,780€,
- "Mbulimi i deponisë " në vlerë 50,100€,
- "Furnizim me mjete të punës" në vlerë 34,197€,
- "Furnizim me pjesë rezervë për automjete" në vlerë 104,512€.

Po ashtu, është vërejtur se zyra e prokurimit në Platformën elektronike E-prokurimi nuk publikon kontratën në tërësi (kushtet e përgjithshme, kushtet e veçanta, specifikacioni teknik, formularin e çmimeve) sipas kërkesave të Rregullores 001/2022 për prokurim publik neni 21.8 pika d

Kjo kishte ndodhur për shkak se stafi i kompanisë ishte i pa trajnuar dhe kompania nuk ka pasur njohuritë e duhura për zbatimin e sistemit në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesëve.

- Ndikimi** Mos shfrytëzimi i modulit për menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit E-prokurimi ndikon që kontratat të mos mbikëqyren në kohë reale dhe potencialisht rritë rrezikun që shërbimet apo furnizimet të mos ofrohen në kohë ashtu siç është nënshkruar kontrata .
- Rekomandimi B8** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë eliminuar të gjitha pengesat të cilat kanë ndikuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore si dhe të sigurojë menjëherë fillimin e përdorimit të moduleve të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Shpenzimet e pagave

Vlera e shpenzimeve të pagave, e prezantuar në PFV ishte 1,583,728€

Çështja B9 - Akontacionet e dhëna punëtorëve pa ndonjë bazë të qartë ligjore

Gjetja Neni 3 i Kodit të Sjelljes dhe Etikës të kompanisë thekson se, çdo punëtor i kompanisë realizon të ardhura, paga dhe shtesa të tjera lidhur me pagën konform kontratës së punës apo vendimit të organit kompetent, andaj çdo përvetësim në forma të tjera konsiderohet i paligjshëm.

Kompania ka prezantuar akontacione ndaj punëtorëve në vlerë prej 44,878€ (51,257€ në vitin 2022), të cilat janë mjete të dhëna vite më parë ndaj punonjësve në formë të paradhënies së pagës. Kompania më 19 nëntor 2018 kishte marrë vendim për kthimin e këtyre mjeteve përmes ndaleses në paga. Lidhur me këtë, kompania nuk kishte ndonjë rregullore të shkruar se kush mund të marr avans dhe sa është periudha e kthimit. Kompania është në procese gjyqësore me disa prej punëtorëve të cilat nuk i kishin kthyer akontacionet.

Kjo kishte ndodh për shkak se kompania e kishte konsideruar të arsyeshme që punëtorëve në raste të caktuara t'u japë mjete financiare në formë avanci me qëllim të kthimit apo zbatimit në pagat e ardhshme të punonjësve. Kompania në planin e veprimit kishte potencuar se është në proces të kthimit të akontacioneve, ndonëse është evidentuar progres për kthimin e tyre, ne kemi vërejtur se kthimi i mjeteve nuk ishte bërë në tërësi.

Ndikimi Pa mundësia e kthimit të akontacioneve ndikon në potencialin financiar dhe zhvillimin e kompanisë.

Rekomandimi B9 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të respektohet vendimi i kthimit të akontacioneve/avanseve në paga nga punëtorët deri në mbledhjen totale të tyre, si dhe të nxirren politika të qarta lidhur me mundësinë e pagesave të tilla nga ana e kompanisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të KRM Uniteti sh.a., ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore. Entiteti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 8 rekomandime janë zbatuar, 9 nuk janë zbatuar ende dhe 1 rekomandim ishte zbatuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 1, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që obligimet tatimore të kompanisë të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK dhe të prezantohen saktë në pasqyrat financiare vjetore.	Nuk janë ndërmarr veprime për adresimin e mangësive të identifikuara ndonëse entiteti në plan të veprimit kishte deklaruar ndërmarrjen e masave për harmonizimin e gjendjes së llogarive tatimore të kompanisë dhe ATK-së.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që është hartuar një regjistër i brendshëm për menaxhimin e pasurive i cili i përmban të gjitha elementet të cilat kërkohen me rregulloren e brendshme.	Nuk janë ndërmarr veprime për hartimin e regjistrit të brendshëm për menaxhimin e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të forcoj kontrollet e brendshme në zyrën e prokurimit në mënyrë që proceset e prokurimit të zhvillohen në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në dosjet e tenderit, si dhe kërkesat e ligjit të prokurimit publik.	Gjate testimit nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi lidhur me përzgjedhjen e ofertës fituese jo në përputhje me kërkesat/specifikat në dosjen e tenderit.	I zbatuar
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes KRM Unitetit dhe palëve të treta/klientëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e kompanisë dhe vizitat të debitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të kërkesave.	Nuk janë ndërmarr veprime për adresimin e mangësive të identifikuara lidhur me harmonizimin e llogarive të arkëtueshme ndonëse entiteti në plan të veprimit kishte deklaruar ndërmarrjen e masave.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët, kurse shuma e provizionit të përcaktohet sipas rregullores për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr veprimet e duhura andaj edhe në këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se para çertifikimit të pasqyrave financiare, ato i nënshtrohen një procesi të rishikimit të hollësishëm në mënyrë që prezantimi i pasurisë afatgjatë, shpenzimeve të zhvlerësimit dhe të hyrave nga granti të jetë i saktë dhe i plotë.	Entiteti nuk ka kryer korrigjimet e nevojshme në prezantimin e saktë dhe të plotë të pasurive materiale afatgjata	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të siguroj se janë bërë korrigjimet e nevojshme tek shpenzimet e zhvlerësimit dhe normat e përcaktuara të zhvlerësimit aplikohen me konsistencë.	Nuk kemi identifikuar mangësi lidhur me nënvlerësimin e shpenzimeve të zhvlerësimit të pasurive afatgjata.	I zbatuar

8.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se regjistrat e kontabilitet janë të saktë dhe të plotë dhe komunikimi dhe shkëmbimi i informatave mes sektorëve në ndërmarrje të jetë në nivelin e duhur.	Mangësitë e identifikuar lidhur me regjistrat e kontabilitetit janë përsëritur edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
9.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve duhet të forcojë kontrollet e brendshme në sektorin e faturimit, në mënyrë që të hyrat të kalkulohen dhe faturohen duke respektuar kushtet e marrëveshjeve me komuna dhe tarifave të aplikueshme sipas rregulloreve përkatëse komunale.	Nuk janë identifikuar dobësi në aplikimin e rregulloreve komunale për menaxhimin e mbeturinave në faturim.	I zbatuar
10.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj për aq sa është e mundur të bëjë një vlerësim paraprak në mënyrë që për furnizimet e tilla të zhvillohen procedura të prokurimit.	Nuk kemi identifikuar mangësi lidhur me shmangien e procedurave të prokurimit.	I zbatuar
11.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që para inicimit të procedurave të prokurimit, të mos ekzekutojë asnjë aktivitet të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë dhe jo-diskriminues. Përveç kësaj, duhet të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të merret vlera për para.	Edhe këtë vit kompania ka kryer prokurime të mallrave të përdorura.	Nuk ka filluar zbatim
12.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të vendos një sistem për qarkullim të dokumentacionit të brendshëm si dhe të sigurojë funksionimin e këtij sistemi brenda kompanisë për evidentimin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit sipas kërkesave ligjore.	Nuk kemi identifikuar mangësi lidhur me mos evidentimin e faturave hyrëse në librin e protokollit.	I zbatuar
13.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë eliminuar të gjitha pengesat të cilat kanë ndikuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore si dhe të sigurojë menjëherë fillimin e përdorimit të moduleve të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës.	Mangësitë e identifikuar janë përsëritur prap lidhur me mospërdorimin e platformës së E-prokurimit.	Nuk ka filluar zbatim
14.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime me qëllim që zhvillimi i procedurave të prokurimit të bëhet në kohën dhe afatin e duhur, duke iu përmbajtur kërkesave qenësore të Ligjit për Prokurimin Publik.	Nuk janë evidentuar raste të shkurtimit të afateve kohore për dorëzimin e tenderëve.	I zbatuar

15.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për një vlerësim dhe planifikim të nevojave të ndërmarrjes dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e hapura të prokurimit, për të rritur konkurrencën dhe transparencën.	Nuk janë identifikuar raste të ndarjes së tenderëve dhe mosaplikimit të procedurës së hapur të prokurimit.	I zbatuar
16.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të respektohet vendimi i kthimit të akontacioneve/avanseve në paga nga punëtorët deri në mbledhjen totale të tyre, si dhe të nxirren politika të qarta lidhur me mundësinë e pagesave të tilla nga ana e kompanisë.	Mangësitë e identifikuara janë përsitur edhe këtë vit ndonëse saldot e akontacioneve janë zvogëluar në krahasim me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatim
17.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të proceduarve të konkursit publik, duke siguruar një proces profesional të përzgjedhjes, transparent, të drejtë që garanton mundësi të barabarta të përzgjedhjes së kandidatëve.	Nuk janë identifikuar mangësi lidhur me procedurat e konkursit publik.	I zbatuar
18.	Funksioni i auditimit të brendshëm	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të funksionalizohet Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit, të azhurnohen dhe plotësohen politikat, procedurat dhe rregulloret për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes, të përgatitet lista e proceseve dhe regjistri i rreziqeve dhe të aplikohet sistemi i nënshkrimeve të dyfishta.	Kompania kshihte emëruar Zyrтарin Kryesor Financiar dhe Sekretarin mirëpo ende nuk ka hartuar rregullore për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, rregullore për rreziqe dhe ende nuk themeluar funksionin e auditimit të brendshëm.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Naim Neziri, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Hasolli, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Prokurimi i mallrave të përdorura	Në gjetjen tuaj tregon se kjo çështje nuk është e ndaluar me ligj por sipas opinionit të KRPP-së, nuk rekomandohet dhe është në përgjegjësi të autoritetit kontraktus. Ne mendojmë se duke mos qenë e ndaluar me ligj, keni bërë gabim që e keni evidentuar si të gjetur andaj kërkojmë që ta përmirësoni këtë çështje.	Komenti nuk është relevant për faktin se kjo çështje është trajtuar në vitin 2021 dhe 2022 dhe Entiteti është pajtuar me gjetjen e auditimit. Për më shumë, opinionit i KRPP (Opinionit i KRPPM 4. 22.11.2022) lidhur me prokurimin e mallrave të përdorura ndër tjera thekson se prokurimi i mallrave të përdorura nuk rekomandohet, ngase specifikimet teknike siç përcaktohen nga autoriteti kontraktues nuk garantojnë domosdoshmërisht se dy apo më shumë mallra që kanë të njëjtat specifikime teknike kanë edhe kapacitetet e njëjta në kushtet performancës dhe funksionalitetit. Po ashtu pamundësia për të krahasuar dy tenderë identik do të përbëjë një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të konkurrentëve.
Mos prezantimi i saktë i obligimeve në regjistrin e kompanisë	Ashtu siç i kemi dhënë sqarime në takim me ju, kjo çështje është duke u trajtuar në Gjykatën Komerciale në Prishtinë andaj nuk mundem të paraqesim shifra tjera pa një vendim të formës së prerë të Gjykatës ku e kemi dëshmuar edhe me dëshmi që i kemi dorëzuar, prandaj konsiderojmë se B6 është gabim i juaj në konstatim dhe kërkojmë ta përmirësoni.	Komenti i entitetit nuk është relevant dhe gjetja qëndron. Çështja është bazuar në vendimin e Gjykatës, nr. 720/2019, të datës 08 janar 2020, ku specifikohet detyrimi i kompanisë dhe ajo vlerë do duhej të prezantohet në PFV e vitit 2023 Pra, derisa ekziston një bazë ligjore ju duhet të vendosni atë vlerë në PFV e vitit përkatës ndërsa nëse vlera ndryshon pas një procesi gjyqësor atëherë vlerat prezantohen në PFV e vitit.

Akontacionet e dhëna punëtorëve pa ndonjë bazë të qartë ligjore	Ashtu siçë kemi biseduar në mbledhjen e fundit kërkojm nga ju që t'i jepni sqarime më të mëdha duke treguar përfundim kohore kur janë dhënë këto Akontacione, me dokumente që ua kemi dorëzuar, ju kemi dëshmuar që këto Akontacione janë dhënë para nëntorit të vitit 2018 andaj për hirë të korreksisë kërkojmë që këto sqarime shtesë ti bëni te çështja B9, edhe me vendimin që i'u kemi dorëzuar ceket që ato janë të ndaluara nga fundi i vitit 2018.	Kompania pajtohet me gjetjen. Janë inkorporuar në gjetje informacionet shtesë.
Mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm	Kompania e ka themeluar funksionin e Auditimit të Brendëshem, por nuk ka Auditor të Brendëshem për shkak se në konkurset e shpallura nuk ka pas aplikues për këtë pozitë, andaj Kompania nuk është fajtoare pse nuk ka interesim për aplikues.	Kompania pajtohet me gjetjen. Janë inkorporuar në gjetje informacionet shtesë.

Leter Konfirmi

Republika e Kosovës-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
ESTE BASHKANGAZUAR: DATE: 30.04.2024 DATE: 30.04.2024			
7-05-2024			
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
47	517	1	

Kompania Regjionale e Mbeturinave
 KRM UNITETI-SH.A.
 Nr. Prot. Svc. 21
 Data 30.04.2024

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Mitrovicë

Datë: 30.04.2024

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:


- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRM Uniteti sh. a., për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe kemi disa komente për përmbajtjen e Raportit; (çështja C1, B6, B7 dhe B9), të cilat mospajtime i gjeni të bashkangjitura në email së bashku dëshmit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

të Kompanisë Regjionale të Mbeturina "Uniteti" Sh.A.

Mitrovicë

z. Fatmir Hyseni




Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet



***KRM "Uniteti" Sh.A. – Mitrovicë
Pasqyrat Financiare për vitin 2023***

Mitrovicë, Mars 2024

Kompania : KRM "UNITETI" SH.A.
Numri Unik Identifikues : 810547911
Komuna : Mitrovicë

PASQYRAT FINANCIARE

Periudha raportuese : 01.01.2023 – 31.12.2023

Përmbajtja :

1. Pasqyra e Fitimit/(Humbjes) dhe të Ardhurave tjera Gjithpërfshirëse
2. Pasqyra e Pozicionit Financiar
3. Pasqyra e Rrjedhave të Parasë
4. Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
5. Shpalosjet dhe Punimet

Përpiloi :

Znj.Ermira DELIJA REXHA

Zyrtare Kryesore Financiare dhe e Thesarit

"KRM UNITETI" SH.A.

KRM "Uniteti" SH.A.

Numri Unik Identifikues : 810547911

Adresa : Vëllezërit Dragaj p.n.

Komuna : Mitrovicë

**Pasqyra e Fitimit/(Humbjes) dhe të Ardhurave tjera Gjithëpërfshirëse - Periudha Raportuese :
01.01.2023 - 31.12.2023**

NR i Zërit	PËRSHKRIMI I ZËRAVE	SHËNIMI	2023	2022
4000	TË ARDHURAT NGA SHITJET	10	€ 3,266,092.32	€ 2,277,224.40
5000	KOSTO E SHITJES		€ -	€ -
H	FITIMI/(HUMBJA) BRUTO		€ 3,266,092.32	€ 2,277,224.40
4100	Të Ardhurat tjera	11	€ 259,109.83	€ 46,668.64
5100	Shpenzimet e shpërndarjes	12	€ (393,724.67)	€ -
5200	Shpenzimet administrative	13	€ (1,635,937.47)	€ -
5300	Shpenzimet tjera	14	€ (630,425.56)	€ (2,282,294.10)
I	FITIMI/(HUMBJA) OPERATIVE		€ 865,114.45	€ 41,598.94
4200	Të Ardhurat nga investimet		€ -	€ -
5400	Shpenzimet financiare	15	€ (2,425.76)	€ (3,610.51)
J	FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT		€ 862,688.69	€ 37,988.43
5500	Shpenzimet e tatimit në fitim		€ (86,268.87)	€ -
K	FITIMI/(HUMBJA) NETO E PERIUDHËS		€ 776,419.82	€ 37,988.43
	TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE			
6000	Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave të operacioneve të huaja, neto nga tatimi	16	€ (47,500.00)	€ -
L	GJITHSEJ TË ARDHURAT GJITHËPËRFSHIRËSE PËR PERIUDHË		€ 728,919.82	€ 37,988.43

KRM "Uniteti" SH.A.

Numri Unik Identifikues : 810547911

Adresa : Vëllezërit Dragaj p.n.

Komuna : Mitrovicë

PPF - PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR PËR VITIN FISKAL 2023 - PERIUDHA RAPORTUESE : 01.01.2023 - 31.12.2023

Nr i zerit	Pershkrimi	Nr i shenimit	Më 31.12.2023	Më 31.12.2022
PASURITË				
Pasuritë afatshkurtëra				
1000	Paraja dhe ekuivalentët e parase	17	€ 50,664.06	€ 14,795.66
1050	Investimet financiare afatshkurtëra		€ -	€ -
1100	Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	18	€ 3,879,352.67	€ 3,219,525.01
1150	Stoqet		€ 59,304.71	€ 48,201.48
1200	Pasuritë e tjera afatshkurtra	19	€ 48,318.25	€ 54,696.80
A	<u>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</u>		€ 4,037,639.69	€ 3,337,218.95
Pasurite afatgjata				
1300	Investimet në pjesëmarrje		€ -	€ -
